



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:240016

Datë: 19.10.2023

Numri i dokumentit: 04803299

K. Nr. 1-1262/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i përgjithshëm –Divizioni i kundërvajtjes, duke vendosur në procedurën e kundërvajtjes ndaj të pandehurit Xhevdet Kurbogaj pronar i subjektit ekonomik Xhevdet Kurbogaj B.I N.T.SH XHEKI me adresë në Pejë për kundërvajtje nga neni 13 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.01/ 2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, në bazë të nenit 55.2, 35,84, 124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje Nr.05/L-087, me datë 19.10.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri : Xhevdet (Ahmet) Kurbogaj si person fizik, pronar i subjektit ekonomik Xhevdet Kurbogaj B.I N.T.SH XHEKI NUI 810424044, Njësia në Pejë, Rr. „Nëna Terezë ” nr. 54, i lindur me 04.07.1975, me Nr. personal 2001373547, më parë i padënuar

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Për shkak se:

Me datë 26.10.2022 në kohë të pacaktuar, me rastin e inspektimit nga inspektorët e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me trupën inspektuese „Sierra Lab” të autorizuar nga MINT (për vlerësimin e konformitetit të karburanteve të lëngëta të naftës) në subjektin ekonomik „Xhevdet Kurbogaj ” B.I. N.T.SH XHEKI në pikën shitëse të NDN-së, Njësia në Pejë, në rrugën „Nëna Terezë ” nr. 54, kanë marrë mostrat e produktit dizel dhe benzinë për të verifikuar cilësinë e derivateve dhe pas analizës ka rezultuar se derivati i testuar dizel me nr. të raportit 585 /2022-TI-M, të datës 27.10.2022 ishte JO KONFORM me parametrat minimale të pikës së ndezjes 55°C, të përcaktuara me nenin 7 të UA Nr.01/2017, por pikën e ndezjes e kishte nën parametrin minimal 43°C, me datë 28.10.2022 është njoftuar subjekti ekonomik dhe ju është dhënë mundësia për kërkesë të ri testimit dhe po të njëjtën ditë ju është marrë edhe një mostër për verifikim të cilësisë për arsye se pronari dëshmon dhe e argumenton me faturë që ka furnizim të ri mirëpo pas arritjes së raportit të inspektimit me nr. të raportit 590/2022-TI-M, të datës 28.10.2022 ka rezultuar prapë JO KONFORM me dispozitat rregullative respektivisht produkti nuk ishte konform me parametrat minimale të pikës së ndezjes 55°C të përcaktuara me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, por pikën e ndezjes e kishte nën parametrin minimal dhe atë 35 °C,

-me çka ka bërë kundërvajtje nga neni 13 paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës

andaj në bazë të nenit 19 paragrafi 8 pika 8.3 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme, dhe me aplikim të nenit 35 të Ligjit për Kundërvajtje

D E N O H E T

ME DENIM ME GJOBË në shumë prej 2500 (dymijepesëqind) Euro, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në afat prej 15 ditësh, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të arkëtohet detyrimisht konform Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Obligohet në pagimin e shpenzimeve procedurale në shumë paushall prej 10 (dhjetë) Euro në të njëjtin afat sikurse edhe dënimin

A r s y e t i m

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Prishtinë – Inspektorati i Tregut ka parashtruar kërkesën e kundërvajtjes Nr. Ref. nr. 19/2022 të datës 07.11.2022 për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes ndaj të pandehurit Xhevdet Kurbogaj B.I. N.T.SH XHEKI për kundërvajtjen e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke kërkuar që i njëjti për kundërvajtjen e kryer të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjatë procedurës së kundërvajtjes pranë kësaj Gjykate është marrë në pyetje i pandehuri Xhevdet Kurbogaj, pronar i subjektit ekonomik „Xhevdet Kurbogaj” B.I. N.T.SH XHEKI i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se thëniet nga kërkesa e kundërvajtjes janë të sakta duke theksuar se në rastin konkret ai furnizohet nga furnizuesi „Hib Petrol” në Ferizaj dhe konsideron se përgjegjësinë e mban furnizuesi në këtë rast ai vetëm të furnizuesi me cisternë i merr derivatet e naftës dhe furnizuesi çdo herë ju ka garantuar për cilësinë e derivateve të naftës dizel dhe benzinë me të cilat furnizohet.

Në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar inspektori i tregut MINT Eljesa Beqiri i cili ka deklaruar se është e vërtetë se me datën 26.10.2022 me kolegun e tij Enver Krasniqi e kanë inspektuar subjektin ekonomik „Xhevdet Kurbogaj” B.I. XHEKI NUI 810424044, me adresë Rr. „Nëna Terezë” nr.54, në Pejë në bashkëpunim me trupën inspektuese Sierra Lab, marrin mostrat për verifikim të cilësisë të produktit dizel dhe benzinë me datë 27.10.2022, sipas test raportit të inspektimit me nr. 585/2022-TI-M rezulton që parametrat e testuar nuk janë konform me UA 01/2017, me datën 28.10.2022, njoftojnë subjektin ekonomik se rezultati i arritur nuk është konform UA 01/2017 kështu që pala e pakënaqur kishte të drejtë të kërkesës për një super analizë apo ri testim në një laborator të akredituar po të njëjtën ditë pasi që pronari dëshmon dhe argumenton me faturë që ka furnizim të ri në bashkëpunim me trupën inspektuese të lartcekur marrin mostrat për verifikim të cilësisë së produktit dizel dhe njëkohësisht bëhet plumbimi i mjeteve rrjedhëse deri në arritjen e rezultateve mirëpo edhe pas arritjes së rezultatit të dytë sipas test raportit 590/2022-TI-M, rezulton se derivati i testuar është jo konform me UA 01/2017, kështu që kanë qenë të detyruar të bëjnë kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, mbrojtja të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit inspektorit të tregut, informata e biznesit nga ARBK, procesverbalit të inspektimit nr.00352/22 të datës 26.10.2022, regjistrimi i marrjes së mostrave datë 26.10.2022, raporti i inspektimit me nr.585/2022 –TI-M, të datës 27.10.2022, procesverbali njoftimi me nr.00356/22 të datës 28.10.2022, procesverbalit me nr. 00357/22 të datës 28.10.2022, regjistrimi i marrjes së mostrave datë 28.10.2022 dhe raporti i inspektimit me nr.590/2022 –TI-M, të datës 28.10.2022 si dhe shkresave tjera të lëndës gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv

